SHPALLJE PËR PLOTËSIMIN E VENDIT TË LIRË TË KATEGORISË SË LARTË DREJTUESE NËPËRMJET PROÇEDURËS SË LËVIZJES PARALELE OSE NGRITJES NË DETYRË NË SHËRBIMIN CIVIL

PROCEDURA
Pranim në kategorinë e nëpunësve civil të nivelit të lartë drejtues

KATEGORIA
Kategoria e Lartë Drejtuese.

POIZICIONI
Drejtor i Përgjithshëm, Drejtoria e Përgjithshme Kujdesit Social, Arsimit, Rinise dhe Sporteve – Klasa I-5

Në zbatim të Nenit 32 të Ligjit nr.152/2013 "*Për Nëpunësin Civil*" (i ndryshuar), si dhe Vendimit Nr.118 datë 05.03.2014 të Këshillit të Ministrave "Për proçedurat e emërimit, rekrutimit, menaxhimit dhe përfundimit të marrëdhënieve në shërbimin civil të nivelit të lartë drejtues dhe të anëtarëve të TND-së", Bashkia Elbasan shpall procedurat e lëvizjes paralele ose ngritjes në detyrë për pozicionin:

- ***Drejtor i Përgjithshëm, Drejtoria e Përgjithshme Kujdesit Social, Arsimit, Rinise dhe Sporteve – Klasa e pagës I-5***

Pozicioni më sipër, i ofrohet fillimisht nëpunësve civilë të së njëjtës kategori për procedurën e lëvizjes paralele. Vetëm në rast se në përfundim të procedurës së lëvizjes paralele, rezulton se ky pozicion është ende vakant, ai është i vlefshëm për konkurimin nëpërmjet procedurës së ngritjes në detyrë.

Për të gjitha procedurat (*lëvizje paralele, ngritje në detyrë dhe pranim në shë shërbimin civil*) aplikohet në të njëjtën kohë.

Afati për dorëzimin e dokumenteve: 06.11.2026
LËVIZJE PARALELE / NGRITJE NË DETYRË/ PRANIM NË SHËRBIMIN CIVIL

Përshkrimi përgjithësues i punës për pozicionin si më sipër është:

Drejtori i Përgjithshëm është përgjegjës për drejtimin strategjik dhe operacional të të gjitha strukturave të drejtorisë.Garanton zbatimin me efikasitet të politikave dhe strategjive të Bashkisë Elbasan në fushat e kujdesit social, arsimit parashkollor, rinisë, sportit, migracionit dhe diasporës. Mbikëqyr planifikimin, koordinimin dhe raportimin e aktiviteteve për secilin sektor në varësi dhe siguron integrimin e shërbimeve me qëllim ofrimin e ndihmës gjithëpërfshirëse për qytetarët dhe komunitetin

Drejtori i Përgjithshëm varet direkt nga Kryetari i Bashkisë Elbasan Ofron mbështetje dhe këshilla për Kryetarin e Bashkisë , në interpretimin dhe zbatimin e strategjive, politikave, planeve dhe buxhetit të Bashkisë Elbasan në lidhje me politikat sociale, arsimore, rinore, sportive dhe migracionit. Harton dhe zbaton strategjinë e përgjithshme të Drejtorisë në përputhje me prioritetet e Bashkisë Elbasan dhe politikat kombëtare. Udhëheq proceset planifikuese për

politikat sociale, arsimore, rinore, sportive dhe të diasporës.Siguron koordinim të brendshëm ndërmjet sektorëve dhe ndjek zbatimin e detyrave të tyre në kohë dhe me cilësi. Koordinon hartimin e planeve vjetore të punës për të gjitha njësitë në varësi dhe përcakton prioritetet e ndërhyrjes.Siguron përputhshmërinë e planeve dhe projekteve me strategjitë kombëtare dhe ndërkombëtare për zhvillimin social, edukimin dhe përfshirjen e të rinjve.

1 E DREJTA PËR TË KONKURUAR

Kanë të drejtë të aplikojnë për procedurën e lëvizjes paralele vetëm nëpunës civil të kategorisë së lartë drejtuese, në të gjitha institucionet pjesë e shërbimit civil.

Kanë të drejtë të aplikojnë për procedurën e ngritjes në detyrë nëpunës civil të kategorisë së mesme drejtuese, në të gjitha institucionet pjesë e shërbimit civil.

Kanë të drejtë të aplikojnë për procedurën e pranimit në shërbimin civil të kategorisë së lartë drejtuese, çdo individ që përmbush kushtet dhe kriteret e poshtëshënuara.

2 KUSHTET DHE KRITERET E VEÇANTA

2.1 Kandidati nëpunës civil i kategorisë së lartë drejtuese për lëvizjen paralele në detyrë duhet të plotësojë kushtet si vijon:

2.1.1. Kushte të përgjithshme:

2.1.1.1 të jetë shtetas shqiptar;

2.1.1.2 të ketë zotësi të plotë për të vepruar;

2.1.1.3 të zotërojë gjuhën shqipe, të shkruar dhe të folur;

2.1.1.4 të jetë në kushte shëndetësore që e lejojnë të kryejë detyrën përkatëse;

2.1.1.5 të mos jetë i dënuar me vendim të formës së prerë për kryerjen e një krimi apo për kryerjen e një kundërvajtjeje penale me dashje;

2.1.1.6 ndaj tij të mos jetë marrë masa disiplinore e largimit nga shërbimi civil, që nuk është shuar sipas këtij ligji;

2.1.1.7 të mos ketë masë disiplinore në fuqi;

2.1.2. Të plotësojë kushtet dhe kërkesat e posaçme, si vijon:

2.1.2.1. të jetë nëpunës civil të konfirmuar, në kategorinë e lartë drejtuese;

2.1.2.2. të ketë të paktën vlerësimin e fundit “mirë” apo “shumë mirë”;

2.1.2.3 të zotërojnë diplomë të nivelit “Master Shkencor” në Shkenca Humane ose Sociale.
(*Diplomat të cilat janë marrë jashtë vendit, duhet të jenë të njohura paraprakisht pranë institucionit përgjegjës për njehsimin e diplomave sipas legjislacionit në fuqi).*

2.1.2.4 të ketë eksperiencë pune jo më pak se 5 vite në nivelin e Lartë Drejtues në Administratën shtetërore dhe/ose institucion etë pavarura;

2.1.2.5 të ketë njohuri të gjuhës angleze, përparësi ka një gjuhë e dytë e BE-së.

2.1.3. Të plotësojë aftësitë si vijon:

2.1.3.1. Aftësi për të drejtuar dhe menaxhuar veprimet e ndryshme;

2.1.3.2. Aftësi komunikimi;

2.1.3.3. Aftësi të drejtimit strategjik;

2.1.3.4. Ndërtim i marrëdhënieve ndërpersonale;

2.1.3.5. Efektivitet;
2.1.3.6. Aftësi pune në grup;
2.1.3.7. Kuptim të gjerë të kompetencave ndërsektoriale;
2.1.3.8. Njohuri mbi fenomenet sociale dhe ekonomike;
2.1.3.9. Besueshmëri;
2.1.3.10. Vizion;
2.1.3.11. Të qenët krijues;
2.1.3.12. Integritet;

2.2 Kandidati nëpunës civil i kategorisë së mesme drejtuese për ngritjen në detyrë duhet të plotësojë kushtet si vijon:

2.2.1. Kushtet si në pikën 2.1. më sipër, përveç kritereve sipas pikws 2.1.2.1. dhe të eksperincës sipas pikës 2.1.2.5, për të cilin jepet përcaktimi si më poshtë vijon.
2.2.2. Të jetë nëpunës civil të konfirmuar, në kategorinë e mesme drejtuese;
2.2.3. Të ketë eksperiencë pune jo më pak se 5 vite në nivelin e Mesëm Drejtues të Administratës Publike dhe jo më pak se 5 vjet në Administratën Publike;

3 DOKUMENTACIONI, MËNYRA DHE AFATI I DORËZIMIT

Kandidatët duhet të dorëzojnë pranë Njësisë së Burimeve Njerëzore të Bashkisë Elbasan, ku ndodhet pozicioni për të cilin ata konkurojnë, dokumentet si më poshtë vijon:

a- Jetëshkrim i plotësuar në përputhje me dokumentin tip që e gjeni në linkun: https://www.dap.gov.al/legjislacioni/udhezime-manuale/60-jeteshkrimi-standard
b- Fotokopje të diplomës (përfshirë edhe diplomën bachelor). Për diplomat e marra jashtë Republikës së Shqipërisë të përcillet njehsimi nga Ministria e Arsimit dhe e Sportit;
c- Fotokopje të librezës së punës (të gjitha faqet që vërtetojnë eksperiencën në punë);
d- Fotokopje të letërnjoftimit (ID);
e- Vërtetim të gjëndjes shëndetësore;
f- Vetëdeklarim të gjëndjes gjyqësore;
g- Dëshmi penaliteti;
h- Vërtetim nga Gjykata dhe Prokuroria e vendbanimit që nuk është në ndjekje penale;
i- Raport mjekësor që vërteton se është i aftë për punë;
j- Vlerësimin e fundit nga eprori direkt;

k- Vërtetim nga Institucioni që nuk ka masë displinore në fuqi;
l- Çdo dokumentacion tjetër që vërteton trajnimet, kualifikimet, arsimin shtesë, vlerësimet pozitive apo të tjera të përmendura në jetëshkrim;
m- 2 referenca nga punëdhenësit e fundit në lidhje me aftësitë e kërkuara për këtë pozicion pune.

Dokumentet duhet të dorëzohen me postë apo drejtpërsëdrejti pranë Bashkisë Elbasan, brenda datës 06.11.2026

4 REZULTATET PËR FAZËN E VERIFIKIMIT PARAPRAK

Njësia e Burimeve Njerëzore - Bashkia Elbasan, do të shpallë në portalin "Shërbimi Kombëtar i Punësimit", ne stendat e informimit të publikut dhe ne faqen zyrtare te Bashkise Elbasan listën e kandidatëve që plotësojnë kushtet dhe kërkesat e posaçme për procedurën e pranimit në kategorinë e lartë drejtuese, si dhe datën, vendin dhe orën e saktë kur do të zhvillohet intervista. Në të njëjtën datë kandidatët që nuk plotësojnë kushtet e pranimit në kategorinë e lartë drejtuese dhe kërkesat e posaçme do

të njoftohen individualisht nga Njësia e Burimeve Njerëzore - Bashkia Elbasan, për shkaqet e moskualifikimit (nëpërmjet adresës së e-mail). Ata mund të ankohen brenda 5 (pesë) ditëve pune nga shpallja e listës. Njësia e Menaxhimit të Burimeve Njerëzore, do të kthejë përgjigje të arsyetuar brenda 2 (dy) ditëve pune.

Në të njëjtën datë kandidatët që nuk i plotësojnë kushtet dhe kriteret e veçanta të lëvizjes paralele dhe ngritjes në detyrë do të njoftohen individualisht nga drejtoria e burimeve njerëzore dhe shërbimeve mbështetëse, nëpërmjet adresës së tyre të e-mail-it, për shkaqet e moskualifikimit.

5 FUSHAT E NJOHURIVE, AFTËSITË DHE CILËSITË MBI TË CILAT DO TË ZHVILLOHET KONKURIMI

Kandidatët do të vlerësohen në lidhje me njohuritë mbi:

1) Legjislacioni ndërkombëtar mbi të drejtat e njeriut;
2) Ligjin nr. 7961, datë 12.07.1995 "*Kodi i Punës i Republikës së Shqipërisë*" i ndryshuar;
3) Ligjin nr. 44/2015, datë 30.04.2015 "*Kodi i Procedurave Administrative i Republikës së Shqipërisë*";
4) Ligjin nr. 139/2015, datë 17.12.2015 *"Për vetëqeverisjen vendore",* i ndryshuar;
5) Ligjin nr.90/2012 "*Për organizimin dhe funksionimin e administratës shtetërore*";
6) Ligjin nr. 152/2013, *"Për nëpunësin civil"*, i ndryshuar, dhe aktet nënligjore dalë në zbatim të tij;
7) Ligjin nr. 9131, datë 08.09.2003, *"Për rregullat e etikës në administratën publike"*;
8) Ligjin nr. 9367, datë 07.04.2005 *"Për parandalimin e konfliktit të intereresave"*;
9) Ligjin nr. 119/2014, *"Për të drejtën e informimit"*;
10) Ligji nr. 69/2012 "*Për sistemin arsimor parauniversitar në Republikën e Shqipërisë*" (i ndryshuar)
11) Ligji nr. 121/2016 "*Për shërbimet e kujdesit shoqëror në Republikën e Shqipërisë*" (i ndryshuar)
12) Ligjin nr. 8517, datë 22.07.1999 "Për mbrojtjen e të dhënave personale", i ndryshuar.

5 MËNYRA E VLERËSIMIT TË KANDIDATËVE

Kandidatët do të vlerësohen në lidhje me :

a- Vlerësimin me shkrim, deri në **40 pikë**;
b- Intervistën e strukturuar me gojë qe konsiston ne motivimin, aspiratat dhe pritshmëritë e tyre për karrierën, deri në **50 pikë**;
c- Jetëshkrimin, që konsiston në vlerësimin e arsimimit, të përvojës e të trajnimeve, të lidhura me fushën, deri në **10 pikë.**

6 DATA E DALJES SË REZULTATEVE TË KONKURIMIT DHE MËNYRA E KOMUNIKIMIT

Në përfundim të vlerësimit të kandidatëve, Njësia e Burimeve Njerëzore- Bashkia Elbasan, do të shpallë fituesin në faqen zyrtare të "Agjencisë Kombëtare të Punësimit" (portalin Shërbimi Kombëtar i Punësimit), faqen zyrtare të bashkisë dhe në stendën e informimit të publikut. Të gjithë kandidatët pjesëmarrës në këtë procedurë do të njoftohen individualisht në mënyrë elektronike, për rezultatet (nëpërmjet adresës së email-it).

Pa cenuar të drejtën e ankimit gjyqësor, sipas legjislacionit në fuqi, kandidatët kanë të drejtë që të ankohen me shkrim brenda 5 (pesë) ditëve nga shpallja e rezultatit. KPP-ja merr vendim brenda 5 (pesë) ditëve dhe, kur është rasti, bën korrigjimin e listës së fituesve të shpallur. Vendimi dhe, kur është rasti lista e korrigjuar, shpallet menjëherë në portalin "Shërbimi Kombëtar i Punësimit", në faqen zyrtare dhe në stendat e informimit të publikut të Bashkisë Elbasan.

DATA E DALJES SË REZULTATEVE TË KONKURIMIT DHE MËNYRA E KOMUNIKIMIT

Në përfundim të periudhës së ankimimit, Institucioni Bashkia Elbasan do të shpallë fituesin në portalin "Shërbimi Kombëtar i Punësimit", në faqen zyrtare dhe në stendat e informimit të publikut të Bashkisë Elbasan Të gjithë kandidatët pjesëmarrës në këtë procedurë do të njoftohen në mënyrë elektronike për datën e saktë të shpalljes së fituesit.